

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6798
E shtunë, 7 janar 2023
çmimi 0.40 €

Osmani: Kosova ka ende nevojë për mbështetjen e aleatëve

FAQE2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KËSHILLTARI I LARTË I DEPARTAMENTIT AMERIKAN TË SHETIT, DEREK CHOLLET, FLET PËR PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

CHOLLET: TË DYJA PALËT KANË DETYRIME NË DIALOG, PRESIM TË LËVIZIN PËRPARA

FAQE 4-5



Këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka bërë me dije se të dyja palët, Kosova dhe Serbia, kanë detyrime në procesin e dialogut. Ai ka thënë se në këtë

drejtim presin që të dyja vendet të lëvizin përpara. Chollet ka theksuar se propozimi i Bashkimit Evropian për një marrëveshje eventuale është një propozim në drejtim "të mirë".


"Do të doja vendime të vështira dhe kurajë nga udhëheqësit, që t'i lënë mënjatë ndasitë dhe të bëjnë atë që është në interesin më të mirë të vendit të tyre", ka deklaruar Chollet

OPINION

PSE O AKADEMIK MEHMET KRAJA?

F.6

Shkruan:
Azem SYLA



AKTUALE



GREQIA NË ALARM, RITJE TË RASTEVE ME KORONAVIRUS DHE GRIP

F.2

HARADINAJ: CILA ËSHTË LOGJIKA E KRYEMINISTRIT KUR THOTË SE SHBA-JA NUK MUND TA PËRFAQËSOJË KOSOVËN

F.5

EKONOMI



KURTI E QUAN QEVERINË E TIJ TË MIRËQENIES PËR QYTETARËT

F.8

GUVERNATORI I BQK-SË: DEFICITI TREGTAR PO E PENGON RITJEN EKONOMIKE

F.8

SPORT



AHMET KANDEMIR RIKTHEHET NË "KB PRISHTINA"

F.12

5 MILIARDË EURO MALLRA IMPORTOI KOSOVA GJATË 2022-S, 370 MILIONË JANË NGA SERBIA

FAQE 7



IKD-ja I KËRKON AVOKATIT TË POPULLIT QË TA PROCEDOJË NË KUSHTETUESE LIGJIN PËR PAGAT NË SEKTORIN PUBLIK

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania do t'i dërgojë Ukrainës dhjetëra autoblanda në pranverë

BERLIN, 6 JANAR - Gjermania do ta furnizojë Ukrainën me rreth 40 autoblanda për këmbësorinë dhe kjo dërgesë është pjesë e një faze të re të mbështetjes së koordinuar me qeverinë amerikane, tha zëdhënësi i qeverisë në Berlin.

Më 5 janar presidenti amerikan Joe Biden dhe kancelari gjerman Olaf Scholz njoftuan se shtetet e tyre do të dërgojnë makina të blinduara për ta ndihmuar Ukrainën që t'i zbrapsë sulmet ruse.

Shtetet e Bashkuara do ta furnizojnë Ukrainën me makina të blinduara Bradleys. Këto lloje makinash janë të pajisura me topa prej 25 milimetrash, me mitraloz prej 7.62 milimetrash dhe raketa kundërtanke.

Gjermania tha se do të dërgojë në Ukrainë makina të blinduara të llojit Marders.

Zëdhënësi i qeverisë gjermane, Steffen Hebestreit, tha të premten se rreth 40 Marders do të dërgohen apo makina të mjaftueshme për të pajisur një batalion.

"Këto 40 makina do të jenë të gatshme të dërgohen në çerekun e parë [të vitit 2023] dhe më pas do t'i dërgohen Ukrainës", tha ai dhe shtoi se Gjermania do t'i trajtojë ushtarët ukrainas që t'i përdorin këto makina.

Për një kohë të gjatë Ukraina ka kërkuar të pajisjet me armatime të rënda, përfshirë tanke, që do t'i lejonin të kryente ofensiva. Shtetet perëndimore kanë hezituat që t'i ofrojnë armë të tilla, duke thënë se kanë frikë se një gjë e tillë do ta provokonte Rusinë. Por, ukrainasit kanë ndërtnuar momentum dhe qeveritë perëndimore kanë



zgjerruar gamën e armëve që po ofrojnë për Ukrainën. Njoftimet nga Shtetet e

Bashkuara dhe Gjermania vijnë një ditë pasi Franca premti se do t'i dërgonte Ukrainës tanke të

lehta të llojit AMX-10 RC. Këto janë makina që mund të bartin topa më të rëndë.

Bideni njofton për masa të reja kundër emigracionit të paligjshëm në ShBA



Uashington, 6 janar - Presidenti amerikan Joe Biden ka njoftuar për masa kundër emigrantëve që përpiqen të hyjnë pa autorizim në Shtetet e Bashkuara nëpërmjet Meksikës, ndërkohë që do të ofrohet mundësia për hyrje të ligjshme për deri në 30 mijë persona në muaj nga Venezuela, Nikaragua, Kuba dhe Haiti.

Këto masa do ta bëjnë më të lehtë për autoritetet kufitare që t'i dëbojnë me shpejtësi emigrantët që hyjnë në Shtetet e Bashkuara në zonat midis pikave kufitare si dhe do të risjellin në fuqi marrëveshjet

dypalëshe ku azilkërkuesit e mundshëm që kalojnë përmes një vendi të tretë duhet të provojnë se nuk iu dhanë mbrojtjet e duhura në atë vend përpara se të kërkojnë azil në kufirin ShBA-Meksikë. Megjithatë, individëve nga katër vendet e lartpërmendura do t'u lejohet të aplikojnë për hyrje të ligjshme në Shtetet e Bashkuara bazuar në autorizimin për falje humanitare, i cili po ushtrohet aktualisht për të pranuar në ShBA disa refugjatë nga Afganistani dhe Ukraina. "Vetëm këto masa që po njoftoj sot nuk do ta ndreqin sistemin tonë të

emigracionit, por mund të ndihmojnë shumë... Unë mund të veproj vetëm aty ku kam kapacitetin ligjor për të vepruar", ka thënë presidenti Biden.

Zyrtarët e administratës Biden e kanë paraqitur këtë plan si një rrugë ligjore për t'u lejuar emigrantëve që të udhëtojnë drejt Shteteve të Bashkuara në një mënyrë të rregullt dhe të sigurt, por aktivistët e emigracionit janë kundërpërgjigjur se këto politika kufizojnë në mënyrë të padrejtë mbrojtjet për azilin të garantuar në ligjin amerikan dhe atë ndërkombëtar.

Greçia në alarm, rritje të rasteve me koronavirus dhe grip

Athinë, 6 janar - Specialistët e shëndetit në Greqi me shqetësim po ndjekin rritjen e rasteve me koronavirus, grip dhe virozat e stinës, siç evidentohen ato nga të dhënat e publikuara prej Organizmit Kombëtar të Shëndetit Publik (EODY).

Gjatë javës së fundit të vitit 2022 janë regjistruar 141 vdekje nga Covid-19, shumica të grupmoshës mbi 75 vjeç, dhe tri vdekje nga gripi, ndërsa është rritur shtrimi në spitale i pacientëve me koronavirus. Por në ditët e para të këtij viti rritje gjithashtu shënojnë edhe rastet

me grip dhe infeksione të tjera respiratore, sidomos te fëmijët dhe të moshuarit.

Shumë spitale në Athinë, Selanik apo në qytetet e vogla të vendit, përballojnë tashmë çdo ditë, përveç koronavirusit, edhe infektimet nga gripi apo virozat e stinës, ndërsa sa i përket virusit respirator sinsincial, numri i rasteve tregon një rënie të lehtë.

Gjendja është rënduar edhe për shkak të mungesës së barnave, sidomos të shurupeve antipiretike, të kollës, ilaçeve që kanë të bëjnë kryesisht me fëmijët, si antibiotikët, ato



kundër dhimbjeve dhe temperaturës etj., ndërsa Ministria e Shëndetësisë ka premtuar se situata do të

normalizohet në javët në vijim. Specialistët janë në mëdyshje sa i përket hapjes së shkollave të hënën që vjen, si faktor që mund të shtojë numrin e fëmijëve që do të preken nga viruset e ndryshme. Gjithashtu, ata po ndjekin me vëmendje përhapjen e nënvariantit të ri të virusit korona në ShBA si dhe ecurinë e koronavirusit në Kinë, ndërkohë që Greqia miratoi masat e propozuara nga BE-ja për udhëtarët nga vendi aziatik në kontekstin e shqetësimit ndërkombëtar për shpërthimin e rasteve atje.

Osmani takon deputetin britanik: Kosova ka ende nevojë për mbështetjen e aleatëve

Presidentja Vjosa Osmani gjatë takimit me deputetin David Lammy, njëherësh sekretar i Jashtëm nën hije i Partisë Laburiste në Mbretërinë Bashkuar, ka thënë se Kosova ende ka nevojë për mbështetjen e aleatëve, duke theksuar rëndësinë që Mbretëria e Bashkuara ta vazhdojë mbështetjen ndaj Kosovës jo vetëm në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar, por edhe në shtimin e bashkëpunimit në fusha të interesit të dyanshëm

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 JANAR - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të premten në takim deputetin David Lammy, njëherësh sekretar i Jashtëm nën hije i Partisë Laburiste në Mbretërinë Bashkuar. Në takim me deputetin Lammy, Osmani ka falënderuar Mbretërinë e Bashkuara për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës që nga vitet e '90 dhe në këtë kontekst ka kërkuar mbështetje të mëtejme për sfidat me të cilat po ballafaqohet Kosova në këtë periudhë.

Presidentja theksoi se Kosova, si një sukses i përbashkët i popullit të saj dhe aleatëve ndërkombëtarë, ka bërë hapa të rëndësishëm për forcimin e demokracisë sikurse edhe të

sundimit të rendit dhe ligjit.

Duke qenë gjithnjë në anën e drejtë të historisë, ajo ka pohuar se Kosova është rreshtuar krah aleatëve edhe me vendimet për sanksione ndaj Rusisë e në mbështetje të Ukrainës. Por, siç potencoi presidentja Osmani, interesimi i satelitit të Rusisë, Serbisë, për ta destabilizuar rajonin e Ballkanit Perëndimor, është më i madh se asnjëherë më parë për shkak se Serbia është e interesuar ta bllokojë suksesin në dialog dhe t'i arrijë qëllimet e saj me dhunë e nëpërmjet bandave kriminale. Prandaj, presidentja Osmani shtoi se Kosova ka ende nevojë për mbështetjen e aleatëve sikurse Mbretëria e Bashkuar në mënyrë që të bëhen hapa përpara për forcimin dhe konsolidimin e mëtejme të pozitës ndërkombëtare si dhe në luftimin e tendencave



destabilizuese ruso-serbe.

Në veçanti, presidentja Osmani potencoi rëndësinë e mbështetjes për anëtarësim në Këshillin e Evropës si dhe në Partneritetin për Paqe të NATO-s si prioritete imediate.

Në takim është diskutuar edhe

për procesin e dialogut me Serbinë, ku presidentja Osmani ka përsëritur faktin se Kosova vazhdon të jetë palë konstruktive, e cila po përballet me obstrukcionet e vazhdueshme të Serbisë. Ajo potencoi se është me rëndësi që

Mbretëria e Bashkuara ta vazhdojë trashëgiminë e saj të mbështetjes ndaj Kosovës jo vetëm në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar, por edhe në shtimin e bashkëpunimit në fusha të interesit të dyanshëm.

KFOR-i hoqi barrikatadat e fundit në veri të Kosovës



MITROVICË, 6 JANAR - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë (KFOR) ka përfunduar heqjen e disa automjeteve të fundit që bllokoni rrugët në veri të Kosovës, ka njoftuar NATO-ja. Heqja e barrikadave është zbatuar në përputhje me mandatin që ka KFOR-i nga OKB-ja - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së nga viti 1999 - për të ofruar një mjedis të sigurt dhe liri të lëvizjes në të mirë të të

gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, thuhet në njoftim. Gjithashtu, në njoftim është thënë se heqja e barrikadave të fundit u bë pas përpjekjeve intensive të aleatëve të NATO-s dhe Bashkimit Evropian (BE) për t'i ulur tensionet me mbështetjen kryesore nga KFOR-i dhe Misioni i Sundimit të Ligjit (EULEX) të udhëhequr nga BE-ja. Demontimi i barrikadave përfundimtare u krye në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt, për t'i

shmangur incidentet dhe rreziqet e tjera për sigurinë lokale, theksoi NATO-ja.

"KFOR-i mbetet jashtëzakonisht vigjilent dhe ka aftësinë dhe personelin që të vazhdojë ta zbatojë mandatin e vet të OKB-së plotësisht dhe në baza ditore, duke kontribuar për sigurinë në Kosovë dhe stabilitetin në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor", thuhet në deklaratë.

Gjithashtu, theksohet se NATO-ja

vazhdon ta mbështesë dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, me ndërmjetësimin e BE-së, si platforma kryesore për gjetjen e një zgjidhjeje që respekton të drejtat e të gjitha komuniteteve dhe për ndërtimin e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme në të gjithë rajonin. Më 10 dhjetor grupe serbësh vendosën barrikada në veri të Kosovës pas arrestimit të ish-pjesëtarit të policisë së Kosovës, Dejan Pantiq, nën dyshimin për

"sulmin terrorist" të 6 dhjetorit ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Më 28 dhjetor Pantiqit iu ndryshua masa e sigurisë nga paraburgim në arrest shtëpiak, gjë që i hapi rrugë tërheqjes së serbëve nga barrikatadat.

Gjykata Themelore e Prishtinës më 5 janar e ka vazhduar edhe për dy muaj masën e arrestit shtëpiak për Pantiqin.

Heqja e barrikadave ka nisur më 29 dhjetor.



KËSHILLTARI I LARTË I DEPARTAMENTIT AMERIKAN TË SHITETIT, DEREK CHOLLET,
FLET PËR PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

Chollet: Të dyja palët kanë detyrime në dialog, presim të lëvizin përpara

Këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka bërë me dije se të dyja palët, Kosova dhe Serbia, kanë detyrime në procesin e dialogut. Ai ka thënë se në këtë drejtim presin që të dyja vendet të lëvizin përpara. Chollet ka theksuar se propozimi i Bashkimit Evropian për një marrëveshje eventuale është një propozim në drejtim “të mirë”. “Do të doja vendime të vështira dhe kurajë nga udhëheqësit, që t’i lënë mënjanë ndasitë dhe të bëjnë atë që është në interesin më të mirë të vendit të tyre”, ka deklaruar Chollet

Prishtinë, 6 janar- Këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, tha se nga udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë duhen të merren vendime të vështira dhe nga ta kërkohet kurajë, në mënyrë që, sipas tij, t’i lënë mënjanë ndasitë dhe të bëjnë atë që është në interesin më të mirë të shtetit të tyre.

Në një intervistë për “Zërin e Amerikës”, Chollet tha se propozimi i Bashkimit Evropian për një marrëveshje eventuale është një propozim në drejtim “të mirë”. “Nuk dua të merrem me detajet e asaj çfarë ka propozuar BE-ja. Mendoj se ndonjëherë, në çfarëdolloj negociatash, është më mirë që këto detaje të lihen pas dyerve të mbyllura, deri në momentin kur

të jenë gati. Por, mendojmë se BE-ja ka parashtruar një drejtim të arritshëm, një drejtim të mirë. Sërisht do të jetë e vështirë. Do të dojë shumë punë. Do të dojë vendime të vështira dhe kurajë nga udhëheqësit, që t’i lënë mënjanë ndasitë dhe të bëjnë atë që është në interesin më të mirë të vendit të tyre”, tha Chollet, duke shtuar se të dy udhëheqësit, në Kosovë dhe Serbi, kanë shprehur dëshirën e tyre për të qenë në rrugën drejt integritetit më të madh në komunitetin euroatlantik. “Ne e mbështetim së tepërmi këtë dëshirë. Duam t’i shohim që të ndërmarrin hapa për ta arritur këtë objektiv dhe duam të bëjmë çfarë të mundemi që t’i ndihmojmë ta realizojnë këtë”, shtoi ai.

Propozimi i BE-së, i njohur edhe si plani franko-gjerman, parashihet të drejtohet barabartë për Kosovën dhe Serbinë, respektim të integritetit territorial, paprekshmëri të kufijve, njohje të simboleve shtetërore dhe një aranzhim të veçantë për komunitetin serb në Kosovë. Por, në tekstin e propozimit nuk përmendet njohja e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Chollet së shpejti pritet të vizitojë Serbinë, por edhe Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. Gjatë kësaj vizite ai tha se do të flasë me liderët për tensionet e fundit midis Kosovës dhe Serbisë.

Chollet tha se është lajm i mirë që barrikatadat në veri të Kosovës janë hequr, por theksoi se është e rëndësishme që të mos përsëriten kriza të tilla. “Shumë më tepër se ç’duhej nga energjia jonë është shpenzuar gjatë javëve të fundit për ta shmangur përkeqësimin e krizës dhe përshkallëzimin e saj në diçka që askush nuk dëshironte ta shikonte, në dhunë. Në vend të kësaj, energjia diplomatike duhet përqendruar tek e ardhmja e Kosovës dhe Serbisë, duhet diskutuar për propozimin

për normalizim, që ka paraqitur BE-ja, që do të ketë në bazë njohjen e ndërsjellë. Ky është drejtimi që Kosova dhe Serbia ta arrijnë destinacionin e tyre euroatlantik”, tha Chollet.

Për 20 ditë me radhë, në dhjetorin e vitit të kaluar, grupe të serbëve lokalë bllokuan rrugët në veri të Kosovës, në shenjë pakënaqësie me arrestimin e një ish-polici serb të Kosovës.

Dejan Pantiq, sipas autoriteteve, dyshohet për organizimin e sulmit ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. Por, vendimi i autoriteteve gjyqësore në Kosovë më 28 dhjetor, për t’ia ndërruar Pantiqit masën e sigurisë nga paraburgimi në arrest shtëpiak, i hapi rrugë heqjes së barrikadave. Pas kësaj, përfaqësuesit e serbëve në Kosovë deklaruan se kërkesat e tyre për heqjen e barrikadave ishin plotësuar.

Chollet në këtë intervistë për “Zërin e Amerikës” foli edhe për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, për të cilin Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje në kuadër të dialogut që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Zyrtari i lartë amerikan tha se Asociacioni “është një prioritet për ne”. “Kemi qenë shumë të qartë për këtë. Besojmë se është një angazhim që është ndërmarrë dhe që duhet të ngrihet. Është qartësisht një hap kyç. Por, ka shumë çështje të tjera. Të dyja palët këtu kanë detyrime. Të dyja palët kanë gjëra për të cilat ne do të donim t’i shihnim që të lëviznin përpara. Prandaj duhet t’i bëjmë këto biseda sa më herët”, tha ai. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është shprehur kundër një asociacioni njëetnik, ndërkaq Serbia insiston që ky asociacion të themelohet.

Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog të ndërmjetësuar nga BE-ja që nga viti 2011. Negociatat mbështeten edhe nga Shtetet e Bashkuara. Procesi i dialogut është thënë se synon të përmbillet me një marrëveshje ligjrisht të detyrueshme. Por, palët kanë dallime edhe sa i përket përfundimit të dialogut. Kosova kërkon që një marrëveshje eventuale ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, ndërkaq Serbia është shprehur se dëshiron një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar për çfarë kompromisi bëhet fjalë.

Haradinaj: Cila është logjika e kryeministrit kur thotë se ShBA-ja nuk mund ta përfaqësojë Kosovën



PRISHTINË, 6 JANAR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj deklaratës së kryeministrit Albin Kurti, i cili tha se: "Unë nuk mund t'i përfaqësoj Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ambasadori amerikan dhe as sekretari i shtetit apo Departamenti i Shtetit nuk mund ta përfaqësojnë Kosovën". "Cila është logjika e kryeministrit kur thotë se ShBA-ja nuk mund ta përfaqësojë Kosovën kur nuk mbahet mend që Amerika ta

ketë kërkuar një gjë të tillë! (Pse nuk i kishte shkruar ndërmend Albin Kurtit të thoshte në vitin 1999 se Amerika nuk mund ta çlirojë Kosovën!)", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Ai ka shtuar se: "Pse ai me çdo kusht kërkon që Amerikën ta bëjë pjesë të problemit kur ajo ishte dhe është pjesë e zgjidhjes. Pse Albin Kurti mundohet ta krijojë përshtypjen se ai mund të jetë viktimë e një 'komploti ndërkombëtar'! Apo po provon

që edhe njëherë ta luajë viktimën, si në vitin 2020!". Haradinaj ka thënë se detyrat dhe obligimet e një kryeministri janë të rënda, aq më tepër në rastin e Kosovës. "Dhe nëse nuk mund t'u bësh ballë sfidave që t'i nxjerr koha përpara, fajin nuk mund ta kërkojë diku tjetër, pos te vetja! Kosova nuk e ka luksin të bëjë eksperimente duke u armiqësuar me partnerët strategjikë por duhet të shtrohet e të rinisë një fazë tjetër

Kurti: ShBA-ja s'mund ta përfaqësojë Kosovën e as unë ShBA-në

Kryeministri Albin Kurti, në një intervistë për "Zërin e Amerikës", ka folur edhe për marrëdhëniet Kosovë - ShBA. Ai ka theksuar se me ShBA-në pajtohet pothuajse gjithmonë, duke shtuar se ka takime të rregullta me ambasadorin amerikan. Megjithatë, Kurti ka vlerësuar se as ai s'mund ta përfaqësojë ShBA-në e as ambasadori amerikan e DASH-i s'mund ta përfaqësojnë Kosovën. "Unë nuk e ndjej këtë, përkundrazi, unë kam takime të rregullta me ambasadorin amerikan për çdo javë dhe jemi vazhdimisht në kontakt e në komunikim dhe pothuajse gjithmonë pajtohem, por jo gjithmonë, sepse unë nuk mund t'i përfaqësoj Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, ambasadori amerikan dhe as sekretari i shtetit apo departamenti i shtetit nuk mund ta përfaqësojnë Kosovën. Ne udhëhiqemi nga idealet amerikane, mirëpo kjo është Kosovë dhe ne duhet ta mbrojmë shtetin tonë, popullin tonë, historinë tonë edhe më shumë sesa që e bën këtë kushdo tjetër. Pra, ne nuk mund të presim që Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta mbrojnë Kosovën në diskurs edhe më shumë sesa vet ne, përkundrazi ne duhet që për Kosovën të kërkojmë edhe më shumë sesa kushdo tjetër, edhe më shumë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka thënë Kurti.

bashkëpunimi. Kjo d.m.th se Kryeministri duhet të bëjë kthesë për 180 shkallë sepse është në drejtimin e gabuar! Ky vit nuk mund të vazhdojë me të njëjtat gabime, sepse me këtë kurs është

vënë në rrezik edhe vet ekzistenca e shtetit. Unë u besoj atyre vendeve, që në krye me Amerikën, na janë gjendur në kohë të vështira", ka shkruar Haradinaj.

Peach takon krerët institucionalë, përmendet marrëveshja gjithëpërfshirëse

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - I dërguari i posaçëm i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Stuart Peach, ka qëndruar për një vizitë zyrtare në Kosovë, ku ka takuar krerët e institucioneve, presidenten e vendit, Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Emisari britanik ka përsëritur përpjekjet për t'i zbutur tensionet në veriun e Kosovës dhe ka inkurajuar riintegrimin e serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës, ka njoftuar Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë. "Është e rëndësishme që të gjithë të përfshirët ta ndalin ciklin e krizave dhe të retorikës së rrezikshme dhe të punojnë për një marrëveshje gjithëpërfshirëse të normalizimit", është theksuar në njoftimin e Ambasadës së Britanisë. Peach është njoftuar nga presidentja Osmani lidhur me zhvillimet e fundit në Kosovë, ndërsa ajo ka theksuar

përkushtimin dhe angazhimin e institucioneve të vendit për paqe dhe siguri, ka bërë me dije Presidenca e Kosovës. Gjithashtu, është thënë se Kosova vazhdon të jetë e koordinuar me partnerët ndërkombëtarë për adresimin e sfidave të sigurisë dhe, në këtë kontekst, presidentja Osmani ka kërkuar "përfshirje më të madhe të Britanisë së Madhe si një anëtare kyçe e NATO-s dhe një partnere historike e Kosovës". "Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova në vazhdimësi është palë konstruktive në raport me dialogun me Serbinë, porse pala serbe nëpërmjet përpjekjeve për destabilizim të Kosovës përpjetat ta zhvendosë fokusin nga dialogu", thuhet në njoftimin e Zyrës së Presidentes së Kosovës. Në këtë frymë, siç thuhet në njoftim, presidentja Osmani ka kërkuar që "ndaj tendencave destabilizuese të Serbisë, bashkësia ndërkombëtare ta mbajë një qëndrim unik duke dënuar veprimet e tilla dhe duke



mos bërë barazimin e palëve kur dihet qartë se kush është agresori". Ndërkaq, në një njoftim nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës, thuhet

se gjatë takimit me Stuart Peach, kryeministri Kurti theksoi marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale dhe rëndësinë e mbështetjes së Mbretërisë së

Bashkuar për Republikën e Kosovës, sidomos në fushën e sigurisë. "U diskutua edhe për sfidat me të cilat po përballon rajoni i Ballkanit Perëndimor, rrezikun që paraqet për sigurinë dhe progresin ndikimi i Rusisë dhe rolin e rëndësishëm të NATO-s në parandalimin dhe sprapsjen e synimeve të Moskës për rajonin tonë", thuhet në njoftim. Kryeministri Kurti tha se "në Kosovë ka progres demokratik, ligjor, ekonomik dhe social që duhet të mbrohet, bashkë me partnerë dhe aleatë". Peach është takuar edhe me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe kryetarin e Mitrovicës, Bedri Hamza. Stuart Peach është emëruar i dërguar i posaçëm i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor në dhjetor të vitit 2021. Asokohe ish-kryeministri britanik, Boris Johnson, tha se emërimi i Peach është pjesë e përkushtimeve të vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar për stabilitet dhe paqe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Pse o akademik Mehmet Kraja?



Shkruan: Azem SYLA

As që kisha ndonjë dëshirë të merrem me ty e shkrimin që ke publikuar në emër të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, por unë jam i tillë që nuk bëhem rehat në qoftë se nuk i them gjërat ashtu siç i ndiej në shpirt.

E pra, more akademik Mehmet Kraja, shumë gjëra mund t'i kem menduar, por që ti të dalësh me vlerësime dhe akuza të tilla shpifëse, tamam si të ishin gatuar në kuzhinën e Beogradit, këtë kurrë nuk e kisha menduar. Veç po të them: Ti hodhe baltë mbi vlerën tonë kombëtare dhe të jesh i sigurt ti, të jenë të sigurt ata që mendojnë si ti (nëse ka), të jenë të sigurt edhe armiqtë, por të jenë të sigurt edhe të gjithë qytetarët shqiptarë, që ne me luftën tonë e kemi bërë shumë mirë detyrën atdheut e kombit, për të cilën jemi krenarë se i kemi vënë një kurorë lavdie historisë kombëtare shqiptare. Ama po të them se shpifjet dhe akuzat tua janë të pafalshme, janë të dënueshme, janë antikombëtare dhe kundër vlerave të shqiptarëve.

Po pse o akademik Mehmet Kraja, a nuk e ke kuptuar akoma se ajo luftë e lavdishme u bë nga ky popull i Kosovës dhe gjithë shqiptarët për të rritur vlerat e fituar lirinë? Pse o akademik Mehmet Kraja, a nuk e ke kuptuar akoma se ata luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk qenë të importuar, siç na kanë akuzuar Serbia dhe bashkëpunëtorët e saj, por qenë

bijtë dhe bijat më të mirë të këtij populli të lavdishëm shqiptar të këtyre trevave të Kosovës e gjithë hapësirave kombëtare shqiptare?

Pse o akademik Mehmet Kraja arrite deri atje sa ta shfrytëzosh emrin e institucionit më të lartë shkencor të Kosovës – Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës – për të dhënë goditje kundër luftës dhe luftëtarëve? Çfarë zori të shtyu bre akademik? A ke diçka të ligë personale apo ke marrë mision prej dikujt, që i shërben ndoshta me apo pa interes, por realisht me ligësi?

Pse o akademik Mehmet Kraja nuk e vlerësove se pavarësisht çka, shqiptari pak i ndershëm nuk e bën e zhbën a bën e maskon fjalën e tij, dhe gjithë kjo në emër të ajkës së dijes së Kosovës, siç veprova ti, duke bërë maskime të ulëta me arsyetime të papranueshme? Se ndryshime nuk bëre.

Pse o akademik Mehmet Kraja dole në këtë pozicion antikombëtar? A mendon se është e rastit, apo kështu ke qenë i ndërtuar mbrapsht, por tani të doli fytyra e vërtetë, apo ndonjë interes i lig? Uroj të mos jetë aq i lig sa të vijë nga Beogradi, por që i shërbeve më mirë dhe më fort se askush tjetër kësaj radhe, kjo po është shumë e qartë.

O akademik Mehmet Kraja, si i keni marrëdhëniet me akademikët e tjerë? A e dëgjove qëndrimin e akademik Sabri

Hamitit? A mendon se nuk do të shkojnë edhe të tjerët në atë qëndrim? Gabohesh o akademik Mehmet Kraja, që mendon se akoma je e mund të jesh koka e asaj akademie. Sepse të jesh në karrigen e kryetarit nuk do të thotë të jesh kryetar. Pasi kryetar je edhe duke mos qenë në atë karrige ku jeni ulur ju, por të tjerët akademikë të përlulen me nderim për dijen që ke. Ndërsa ti ku je sot? A je kryetar? Nuk besoj, veç i ndonjë të pamerituar, që ti vetë më herët ke thënë se janë të pamerituar, i cili mund të t'i përkëdhelë krahët. Sa keq për ty o akademik!

Po pse o akademik Mehmet Kraja pa përgjegjësi del dhe deklaron se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit? A e njeh ti rrjedhën e asaj lufte dhe atë ushtri që bëri luftën. Po ti u ktheve në shtëpinë tënde veç kur ata luftëtarë e çliruan Kosovën bre? Ku i pe ti ato krime, a nëpër Evropë ku ishe në ato kohë? Çudi more zotëri me ty. Unë kurrë nuk kam menduar se mundesh ti pa as më të voglin informacion t'i ngarkosh vetes atë barrë aq të madhe sa të përpiqesh t'i shfajësosh krimet serbe duke e kriminalizuar luftën e shenjtë të popullit shqiptar për liri e pavarësi. Mision i rëndë ky i yti, zotëri. Por punë të tilla si kjo puna që bëre ti, deri tani kanë bërë vetëm shërbimet antishqiptare. Ndërsa për ty dua të them se duhet të kesh ndonjë interes të madh ose ke marrë

ndonjë urdhër të rëndë.

O akademik Mehmet Kraja, a e di se një ditë Hashim Thaçi do të kthehet me pafajësi nga Gjyqi i Hagës, po ti ku do t'i fusësh ato fjalë që ke thënë për të? Sepse ai e ka kryer detyrën ndaj atdheut me armë në dorë kur ti nuk di ku ishe. Ashtu sikurse edhe atje ku është ka shkuar për të mbrojtur me bindje pastërtinë e asaj lufte. Ndërsa ti përpiqesh ta trajtosh Hashim Thaçin si të ishte ndonjë hajn, që përpiqet të fshihet nga e vërteta e hajnisë të tij. Jo o akademik Mehmet Kraja, ai dhe të gjithë luftëtarët, bashkë me mua, që kur ka ngritur dorën për ta miratuar atë ligj të kësaj gjykate, e ka ditur se do të jetë atje për ta mbrojtur pastërtinë e kësaj lufte, siç e kanë ditur të gjithë ata që e kanë votuar atë ligj. Luftëtarët, o akademik Mehmet Kraja, nuk janë prej atij malli që fshihen as që e merr era, siç merr qëndrimet tua. Po Ali Ahmeti o akademik Mehmet Kraja çfarë borxhi të ka? A edhe ai po të bën hije, pse po udhëheq shumë - shumë mirë politikën shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut? A kaq dhimbje ke nga sukseset që kanë arritur shqiptarët në të drejtën e tyre në atë shtet?

Si nuk i more në mbrojtje as edhe me një fjalë shqiptarët në Kosovën Lindore bre akademik Mehmet Kraja? Veç se u the që kurrë nuk do të jenë pjesë e Kosovës, a për t'i moralizuar ua the këtë, që të mundësosh të

ikin nga sytë këmbët? Jo zotëri, gabohesh përsëri, koha e ikjes së shqiptarëve dhe e shpërnguljeve të tyre ka perënduar njëherë e përgjithmonë. Kosova Lindore do të jetë Kosovë Lindore sot e përgjithmonë. Mos e harro këtë akademik.

Po Shqipëria çfarë të ka bërë që nuk le gjë pa thënë për të? Apo se të jepte bukë kur nuk kishe shtëpi. Sa keq. Po si nuk e the një fjalë të mirë për shqiptarët more akademik Mehmet Kraja? A nuk ka asnjë shqiptar tjetër përveç teje që të meritojë të jetë ai që i duhet kombit shqiptar?

Pse o akademik Mehmet Kraja ke mendimin se askush nga udhëheqësit shqiptarë në gjithë hapësirën kombëtare nuk është i aftë të udhëheqë shqiptarët, nuk është i pastër të udhëheqë shqiptarët, nuk është i ditur të udhëheqë shqiptarët, nuk është me vizion të udhëheqë shqiptarët? Po kush mendon ti se duhet t'i udhëheqë shqiptarët? Pasi ne paskemi fuqi të korruptojmë edhe shtetet e botës, të korruptojmë edhe organizatat ndërkombëtare, si i bëhet?

Jo akademik Mehmet Kraja, Serbia nuk kthehet më. Nuk kthehet.

(Autori ka qenë komandant i përgjithshëm i UÇK-së. Ky artikull është shkruar për gazetën "Epoka e re", "Kosovapress" dhe "Radio Kosova e Lirë")

IKD-ja i kërkon Avokatit të Popullit ta procedojë në Kushtetuese Ligjin për Pagat në Sektorin Publik

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 JANAR - Instituti i Kosovës për Drejtësi ka deponuar të premtën tek Avokati i Popullit kërkesën për fillimin e hetimeve për shkelje të të drejtave të njeriut dhe inicim në Gjykatën Kushtetuese të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Përmes kësaj kërkesë, IKD-ja ka kërkuar nga institucioni i Avokatit të Popullit që, sipas kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, ta procedojë Ligjin Nr. 08/L-196 Pagat në Sektorin Publik për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese. “Me qëllim të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, reagimi i Avokatit të Popullit në këtë situatë është i domosdoshëm. Përmes kësaj letre IKD kërkon nga Avokati i Popullit që ta trajtojë këtë çështje dhe në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore ta iniciojë Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese”, thuhet në kërkesën e IKD-së.

IKD-ja më 22 dhjetor 2022 ka publikuar analizën “Pagat në Sektorin Publik”.

Në këtë analizë gjetjet e IKD-së tregojnë për probleme serioze kushtetuese të tanimë Ligjit Nr. 08/L-196 për Paga në Sektorin Publik.

IKD-ja ka gjetur se ligji cenon sigurinë juridike të nëpunësve të



sektorit publik, duke mos përcaktuar vlerën monetare të koeficientëve.

Sa i përket uljes së pagave, Ligji ka përcaktuar rregulla adekuate për mbrojtjen e nëpunësve nga ulja e pagave. Por, IKD-ja ka gjetur se ligji i mbron këto rregulla vetëm për të ardhmen, por se nuk i aplikon për të kaluarën, pasi ligji në fjalë nuk ka një zgjidhje adekuate në raport me nëpunësit e sektorit publik të

cilët ndikohen negativisht nga ky ligj.

Ndonëse ky ligj nuk ka përcaktuar vlerën monetare të koeficientit, nga fryma e përgjithshme e tij (si p.sh. përcaktimi i dispozitave mbi shtesën transitore) dhe nga disa prej raportimeve, shihet një tendencë për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Me këtë rast, IKD-ja tërheq vëmendjen se ulja e pagave të

gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë situatë është në kundërshtim me kërkesat që rrjedhin nga Aktgjykimi nr. KO219/19 dhe në kundërshtim me opinionet e Komisionit të Venecias, të cilat kanë krijuar tashmë praktikë dhe standard ndërkombëtar në raport me pagat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Në disa raste të tjera, IKD-ja ka gjetur se ligji në fjalë përmban

dispozita të cilat paraqesin trajtim të pabarabartë të nëpunësve të sektorit publik, aspekt ky që paraqet shkelje të nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Po ashtu, IKD-ja ka gjetur se ligji përmban dispozita të cilat cenojnë pavarësinë funksionale të sistemit të drejtësisë, i cili cenim paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Realizohet plani operativ ‘Mjegulla’, policia kap 40 kilogramë substancë narkotike



PRISHTINË, 6 JANAR - Hetuesit policorë nga Sektori Qendror i Drejtësisë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve për disa javë kanë trajtuar përmes rrugëve operative e hetimore një informacion se ‘një person po merrej me trafikim të lëndëve narkotike’. “Më 05.01.2023, rreth orës 17:08, është arritur të lokalizohet dhe identifikohet një i dyshuar i përfshirë në veprën penale ‘blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge’. Hetuesit policorë, në koordinim me organet e drejtësisë, kanë realizuar Planin Operativ ‘Mjegulla’, gjatë realizimit të të cilit në flagrancë është arrestuar i dyshuari: N. B.,

(viti i lindjes 1986, mashkull kosovar), i cili po transportonte me një veturë me targa vendore substancë narkotike që dyshohet të jetë marihuanë”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Gjatë kontrollimit të veturës janë gjetur rreth 40 kilogramë substancë narkotike, e cila dyshohet të jetë e llojit marihuanë, e ndarë në 40 paketime të mbështjella me qese plastike. “Vlera e kësaj sasive sillet rreth 80 mijë euro dhe dyshohet se vendi ynë ishte transit i kalimit të kësaj sasive, kurse destinacion final ishin vendet e Perëndimit. Personi i dyshuar është intervistuar dhe me aktvendim nga prokurori i njëjti dërgohet në mbajtje deri në 48 orë”, ka njoftuar policia.

Rama takon presidentin Begaj, diskutojnë për tri çështje

TIJANË, 6 JANAR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është takuar të premtën me presidentin Bajram Begaj, me

të cilin ka diskutuar mbi çështjet kryesore të këtij viti qeverisës. “Takimi i fillimvitet me kryetarin e shtetit për ta

informuar mbi çështjet kryesore të këtij viti qeverisës si edhe për ta përgatitur mbledhjen e Këshillit të

Sigurisë Kombëtare dhe ndryshimet e ambasadorëve në misionet tona diplomatike”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



Bisedë me Kadri Halimin (1)

Punët po shkojnë fort ngadalë

Në shtëpinë e Kadri Halimit, në prani të bashkëshortes, bisedojmë për jetën e tij, që nga lindja e deri më sot

Baca Kadri, na tregoni datëlindjen, vendin, emrin e babait, të nënës, sa vëllezër, sa motra i keni?

– Jam i lindur më 9 shkurt 1921 në katundin Cërrnicë, në një familje të madhe. E mbaj mend kur familja jonë kishte 42 anëtarë.

Nëna?

– Nëna ishte nga Sllatina. Babai e ka pasur emrin Muharrem Halimi nga Cërrnica.

Sa fëmijë?

– Unë isha më i madhi vëlla. Kisha edhe dy vëllezër. Kam pasur dhe katër motra.

Emrat e vëllezërve?

– Vëllai pas meje e ka pasur emrin Mehdi. Ai ka dalë për të jetuar në Gjilan. I treti ka qenë Ramadan Halimi. Ai ka vdekur.

Motrat?

– Motra e madhe e ka pasur emrin Fatime. Ajo ka shkuar në Turqi nga Gjilani në vitin 1956. E dyta motër ishte Mevlydja, e treta Nazlija dhe e katërta Eshrefja.

Çka keni mbajtur mend për jetën e prindërve?

– Babai ka marrë pjesë në luftën kundër turqve në Kaçanik. Aty është plagosur në krah. Është dënuar me tetë vjet burg. Burgun e ka vuajtur në Prishtinë. Këtë më ka treguar baba. Më ka treguar si është zënë dhe si është dënuar. Më ka mbetur kujtim përherë. Kështu e kam kuptuar prej tij se si duhet luftuar për atdhe. Mbasandaj, në kohën e Mbretërisë jugosllave, 7-8 vjeç më kanë dërguar në shkollën fillore dhe e kam kryer shkëlqyeshëm. Mësuesi im ka qenë serb i Gjilanit. E ka pasur emrin Branislav Trajqi. Ai mësues, sa herë e takonte babin, i thoshte: Djali duhet dërguar edhe më tutje në shkollë, pasi po mëson mirë. Kështu, pasi kuvenduan burrat në shtëpi, vendosën të më dërgonin në gjimnaz, në Medresenë e Madhe në Shkup.

Gjatë asaj kohe, a keni dëgjuar për dhunën serbe mbi shqiptarë? A mbani mend ndonjë rast konkret që ju kujtohet? Keni pasur serbë edhe në fshat? Edhe sot ka?

– Axha i madh ka treguar dhe ato i mbaj mend se si shkiet kanë bërë shumë zullum mbi shqiptarë. Mirëpo gjyshi ka qenë shumë i nderuar edhe prej krejt fshatarëve, serbë e shqiptarë. E mbaj mend se si vinin serbët në odë dhe e ia uronin Bajramin gjyshit. Ndonjë të keqe nuk kemi

pasur me ta kurrë. Prej shkollës fillore më dërguan në Medresenë e Madhe në Shkup, si bursist, me shpenzime të shtetit. E dhashë provimin pranues me sukses. Asokohe pushteti mundahej të përfshinte nxënës nga të gjitha rrethet e Kosovës. Nga Rrethi i Gjilanit më pranuan vetëm mua. Aty, kur kam shkuar në Shkup, i kam gjetur Esat Berishën dhe Isak Sherifin nga Gjilani. Aty ka qenë edhe Ramadan Jusufi i Cërrnicës. I kam njohur edhe Idriz Ajetin, Ramiz Ajetin, Zeqir Bajramin e Jusuf Ajetin e Tupallës. Ky ka vdekur. Ka pasur nxënës të Medresesë edhe nga Prizreni e nga Peja.

Sa vjet përpara ishte hapur ajo medrese në Shkup?

– I ka pasur nja 10 vjet.

A i mbani mend emrat e shqiptarëve që janë shkolluar më parë aty?

– Mbaj mend Isakun nga Gjilani, Shaip Mustafën...

Në cilin vit jeni regjistruar? Në vitin shkollor 1933-'34.

Si bursist i Gjilanit ishit vetëm ju?

– Po. Edhe ata që i përmenda kanë qenë bursistë, por që i kam gjetur aty. Aty jam shkolluar shtatë vjet. Si e kreuva maturën, krisi lufta. Bile na lëshuan dhe e ndërpreme mësimin. Më kujtohet si sot, më 6 prill ka filluar lufta. Baba atë ditë kishte ngarkuar do thasë me drithë për të shkuar në mulli. Pikërisht, kur ne po shkonim rrugës me qerre, arritën avionët dhe e bombarduan Ferizajn. Ushtria jugosllave guante me artileri dhe qëllloi një avion gjerman. Tymin ia kemi parë kur është përplasur shumë afër në male, këtu te ne, në Cërrnicë. Shumë shpejt kapitulloi Jugosllavia.

Gjatë studimeve, a keni ndonjë kujtim për ndonjë profesor apo si ishte shkollimi? A keni marrë pjesë në demonstrata që janë bërë në Shkup?

– Ajo Medrese ka qenë ndër shkollat më të forta në Jugosllavi. Shkolla jonë dhe një gjimnaz në Zagreb kanë qenë shkollat më të forta në Jugosllavi. Të gjithë medresantët, që kanë mbaruar atë shkollë, kanë dalë intelektualë të fortë, të pajisur me dije. Në këtë medrese i transferonin profesorët më përparimtarë dhe më të fortë, por që i kishin diktuar se ishin në lëvizje komuniste e antifashiste dhe, si dënim, i dërgonin për punë këtu në Medrese. Kështu, ne kemi pasur fat që kemi qenë



në atë shkollë. E kam kryer pastaj fakultetin, por nuk kam përfutur asgjë më shumë nga ajo dije që kam marrë në Medrese. Klasën e tetë e kam kryer në Prizren, pas luftës. Në të '45-tën e kam kryer klasën e tetë me sukses shumë të mirë.

Si keni kaluar me shokë dhe a keni përjetuar padrejtësi aty?

– Kam pas punuar aty shumë në planin politik, por edhe letrar e kulturor. Aty ka qenë një shoqatë letrare, që i thoshin "Juzhna Villa". Kuptohet që në shoqatë punohej e mësohej në gjuhën serbe. Aty çdo vit zgjidhej kryetari i ri i shoqatës. Kështu, deshi fati që unë të isha kryetari i fundit i asaj shoqate. I pari ka qenë Edip Hasanagiqi. Atë nuk e kam hasur aty, por kam kuptuar nga shokët.

Me çfarë aktiviteteve merrej ajo shoqatë?

– Merreshim me tregime, vjersha, orë letrare... Megjithëse kishte shqiptarë, aty vinin edhe shumë boshnjakë nga Sanxhaku e Bosnja.

A dinin këta boshnjakët e Sanxhakut që kanë origjinë shqiptare a jo?

– Disa po, disa jo. Vetën e quanin malazias. Kishte boshnjakë me mbiemrat Rexhepagiq, Shaboviq. Ka pasur individë që pranonin se janë asimiluar. Ata kanë të gjitha traditat shqiptare, që nga zakonet e doket, e deri te dasmat e veshja, dhe e pranojnë se janë asimiluar. Shembulli më i mirë ka qenë Qamil Sijariqi, i cili dajati i ka pasur shqiptarë, nënën shqiptare, edhe e ka mbajtur veten si shqiptar, por nuk deklarohet hapur. Edhe Radovan Zogoviqi prejardhjen e ka shqiptare!?

– Shoqata letrare mblidhej një herë në muaj. I lexonim punimet tona që i kishim shkruar.

A është afirmuar ndonjë poet nga shqiptarët, pasi e keni kryer shkollën aty?

– Nuk më kujtohet.

Esad Mekuli, a ka qenë në atë shkollë?

– Nuk e di. Zenel Hajdini ka qenë në Medrese. Pasi ai ishte nxënës i shkëlqyeshëm, është liruar nga provimi i maturës. Ka qenë me fytyrë të kuqe. Ai ka qenë talent i madh. Në medrese jam shoqëruar më së shumti me katundarin tim Ramadan Jusufi. Ai ka qenë tri klasa para meje. E mbaj mend gjatë pushimeve verore, kur erdhën mysafirë te Ramadani këta të Tupallës, të gjithë e kishin blerë nga një plis të bardhë. Ishin Idriz Ajeti, Zeqir Bajrami, Isuf Ajeti, Ramiz Ajeti e me ta ishte edhe Rexhë Ibishi. Për midis Gjilanit kaluan me plisa të bardhë. Këta e bënë këtë si një mënyrë demonstrative, duke kaluar përmes Gjilanit për të shkuar në Cërrnicë. Ai moment më është ngulitur thellë në zemër.

A ishit ju në atë muhabet? Çka është folur aty?

– Më së shumti është biseduar për gjendjen e shqiptarëve. Sidomos është biseduar për të mos u shpërngulur në Turqi. Ankoheshin se duhet luftuar shumë më tepër kundër kësaj shpërnguljeje. Populli shqiptar të mos i lërë shtëpitë e veta.

Pasi ishte Idriz Ajeti aty, a eksponohej, a dallohej?

– Jo! Ka qenë njeri i urtë, siç njihet edhe më vonë. Edhe si nxënës ka qenë mesatar. Nuk ka qenë nxënës i shkëlqyeshëm. Zenel Hajdini ka qenë nxënës i

shkëlqyeshëm.

A keni dëgjuar që si Zenelin, ashtu edhe Abdullahun, i kanë eliminuar shkiet, pasi këta të dytë kanë qenë shumë të aftë? A keni dëgjuar se si ua kanë përgatitur kurthin?

– Kur e kanë rrethuar çetnikët, Zenel Hajdini ka rezistuar. Zeneli ka luftuar me armë në dorë dhe, derisa e kanë vranë, nuk është dorëzuar. Sigurisht ia kishin përgatitur kurthin.

A e kanë vranë Zenelin çetnikët, të veshur si partizanë apo si?

– Këtë nuk e di.

A keni qenë në demonstratën që është bërë në Shkup kundër pushtimit italian?

– Po, po. Na thoshin, u shkel Shqipëria. Ne u thoshim se do t'ju vijë radha edhe juve shpejt. Pra, i vjen radha edhe Jugosllavisë. Dhe ashtu ndodhi shpejt. Ne demonstruam kundër pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Krejt ata që e mbanin veten më internacionalistë thoshin se edhe Jugosllavisë i vjen radha. Skënder Kadriu ka qenë shumë i gjallë në atë demonstratë.

Rexhep Bunjaku thotë se Skënderi ka qenë shumë trim dhe nuk kanë guxuar kurrë t'ia kontrollojnë çantën?

– Nuk e di për këtë, por trim dhe guximtar ka qenë.

Gjatë asaj kohe, kur dihet për lëvizjen komuniste, a ka ndodhur të arrestojnë dikë në shkollë?

– Afër Medresesë ka qenë ambasada e Shqipërisë. Ata që shkonin e kontaktonin me ambasadë, nëse i kanë zënë, i kanë përjashtuar nga shkolla. Aty, në konsullatë, merrnin ndonjë libër a gazetë. Më

kujtohet që më ka pas rënë në dorë gazeta "Sazani". Ajo botohej në Francë, por aty e merrnin, në konsullatë. Ka qenë shumë rrezik të shkohet në konsullatën shqiptare. Librat shqip kanë qenë të ndaluar rreptësisht.

Cili libër lexohej, nëse ju ka rënë në dorë ndonjëherë?

– Nuk më kujtohet ndonjë.

Po demonstrata e Shkupit, si u prit nga populli?

– Ne, që ishim nxënës, nuk na lejonin të dilnim. Na mbanin mbyllur. I patëm kërcyer muret dhe i patëm thyer dyert e patëm dalë krejt në demonstratë. Drejtor ka qenë Ahmet Mehmedbashi. Ai ishte përgjegjës dhe nuk na lejonte të dilnim, por ne dolëm.

Kur Gjermania invadoi Jugosllavinë, shkolla u mbyll?

– Po, e mbyllën shkollën.

Ajo shkollë më nuk është hapur?

– Jo. Ajo shkollë më nuk është hapur.

Pasi u kthyet në Cernicë?

– U vendos ai pushteti shqiptar.

Sa vjeçar keni qenë?

– Njëzetvjeçar. Shkova në Gjilan dhe gjeta punë. Kam pas punuar në postë. Kam qenë telegrafist. Edhe sot e njoh atë punë. Pastaj e lashë punën e u regjistrua këtu në Prishtinë, në degën e Liceut.

Sa vjet keni punuar?

– Më duket dy a tre vjet, po.

A keni njohur dikë në Gjilan dhe a bisedonit me ndokënd, gjatë atyre viteve sa keni punuar aty?

– Këtu në Prishtinë e regjistrua degën e Liceut, por nuk na e pranoin klasën e shtatë. Pasi shkolla qe ndërprerë nga lufta, nuk kishim ndonjë dokument. E bëmë njëfarë si grevë a si protestë, dhe mua më përjashtuan nga shkolla menjëherë, si organizator të asaj greve. Mua më përjashtuan përgjithmonë nga të gjitha shkollat e Shqipërisë. Në Shkup Taip Bogiqin e kam pasur kujdestar klase. Ai nuk e duronte fashizmin fare. Pasi shkoi në Sarajevë, iku për Turqi dhe më vonë ishte bërë profesor universiteti dhe ka vdekur atje. Gjatë deklarimit të përkatësisë kombëtare asokohe, profesorët, si për mahi, na kanë pyetur ndonjëherë për përkatësinë kombëtare, por jam deklarua "arrnaut". Të tjerët deklaroheshin crnogorac a srbin. Unë një herë thashë jam albanez.

Pasi ju përjashtuan në Prishtinë nga shkolla, çka bëte pastaj?

– Jam kthyer në Gjilan dhe kam filluar punën në postë.

Gjatë kësaj kohe, sa ishit në Gjilan, a kontaktonit me ndokënd, a bisedonit për situatën?

– Po, kam pasur shokë, sigurisht.

Cilët janë ata?

– Me Halil Fejzullahun, nga Tygjeci. Edhe ai punonte në

postë. Ai nuk ka pasur lidhje me punën që mori, por ashtu ishte koha. Ai nuk kishte përcaktim politik dhe mua ma kanë dhënë si obligim për ta përvetësuar atë.

Po na tregoni si u bëtë komunist? Gjatë shkollimit në medrese apo?

– Jo, në medrese kam qenë SKOJ-ist.

Kush ju ka angazhuar në këtë drejtim në Medrese, dhe me cilin keni rënë në kontakt?

– Po nuk e di, por vinin studentë nga fakulteti filozofik i Shkupit dhe ashtu ramë në kontakt.

Ishte ai njeri serb apo shqiptar?

– Jo, serb ka qenë. Aty më pranuan në SKOJ. Si anëtar i SKOJ-it kam qenë prej vitit 1939.

A keni paguar anëtarësi apo jo?

– Jo!

Keni marrë ndonjë dokument apo programin?

– Jo!

A keni formuar celula të partisë në Gjilan?

– Aty, kur e kemi formuar celulën e partisë në Gjilan, kanë qenë të pranishëm Isak Berisha, Vesel Rexhepi, Vebi Rexhepi. Insistimi ishte të bëhen bashkë serbët e shqiptarët, por ne e bëmë celulën, por pa serbë, sepse ata nuk donin të bashkoheshin me shqiptarë.

Kush ishte kryetar?


– Kurtesh Agushi ka qenë. Ai ka qenë anëtar partie prej '38-tës. Në atë kohë, kur dilnin partizan, i caktonte partia. Edhe Xheladin Kurbalia i Karadakut, ka qenë shumë i zoti dhe patriot i madh.

A ka qenë e domosdoshme të pranohen disa serbë? Milladini, Dizdareviqi e misionarë të tjerë? A ka qenë e detyrueshme që ata t'i pranojë Enver Hoxha, apo?

– Përmes Partisë Komuniste të Italisë është bërë përpjekje të bëhet pranimi i Shqipërisë në Kominternë. Pa u pranuar në Kominternë, nuk ke mundur të dëshmosh se i takon lëvizjes komuniste. Por, lidhjen në Kominternë, Shqipërisë ia ka mundësuar Partia Komuniste e Jugosllavisë. Përmes Partisë Komuniste të Italisë nuk ka mundur të realizohet kjo lidhje. Ka tentuar Qemal Stafa, por nuk ia ka dalë. Kështu, jugosllavët, kinse në emër të autorizimit nga Kominternë, janë futur në Shqipëri.

Çka ndodhi në Konferencën e Pezës? Pasi ka reaguar ashpër Milladini, ka folur Ymer Dishnica. Thuhet se me insistimin e Milladinit është prishur marrëveshja e Mukjes?

– Unë kam pasur rast të takohem atje me njerëz kompetentë, por këtë nuk ma kanë thënë. Këta të Ballit brenda strukturave të tyre kishin lloj-lloj njerëzish. Ata kanë bërë gjëra të këqija. Në shumicën e rasteve vetëm kanë ngrënë e kanë pirë raki. Ashtu edhe kanë vrrarë edhe djem të rinj, akoma të mitur, krejt me akuzë se ata janë ndikuar nga komunistët. Krejt puna ka qenë



Prof. KADRI HALIMI
(etnolog)
(1921 - 2001)

te ndarja e pushtetit pas luftës. Kur dihet se krejt luftën e kishin bërë partizanët, aty thuhet se partizanët nuk pranojmë që ballistët të na e fëlliqin luftën, pasi ata nuk kanë bërë asnjë luftë kundër pushtuesit dhe vetëm kanë bashkëpunuar me okupatorin. Edhe UÇK-ja bëri gabim që pranoi ndarjen e pushtetit me LDK-në. Rugova ka thënë burgosni këta. Në një rast Sali Berisha ka thënë, thuaj Aliut, largoje djalin, ose s'kemi çare pa e burgosur. Në Shqipëri i kanë burgosur ushtarët e UÇK-së si terroristë. Njerëzit tanë nuk mund të krahasohen me banditë të Shqipërisë e të burgosen e trajtohen ashtu, sepse nuk kanë asnjë lidhje me ta. Rugova duhet të dënohet për formimin e politikës pacifiste, që i ka shkuar në favor Jugosllavisë. Ndarja e pushtetit mes UÇK-ës dhe LDK-së do të na kushtojë shumë. Prandaj edhe Enveri atëherë nuk pranoi ta ndante pushtetin me ballistët e Shqipërisë.

Baca Kadri, ju deklaruat se u formua Partia Komuniste Shqiptare në Gjilan. A pati bashkëpunim me serbë ndonjëherë?

– Jo.

Keni bërë parti Komuniste e nuk janë bërë bashkë shqiptarët me serbët? Si e shikonit ju këtë? Kush ishte kryetar i grupit serb aty?

– Njëfarë Popoviqi ka qenë. E kam njohur. Ai Popoviqi ka qenë sekretar i komitetit të rrethit të Gjilanit. Sipas përshlyesjes sime,

ai ka qenë shumë i drejtë. Njëherë, duke shëtitur në korzo, i thashë, çka ta merr mendja, se nga do të shkojë tash Kosova? Ai po thotë, pasi shumica janë shqiptarë, do të shkojë me Shqipëri. Megjithatë, unë nuk u kam besuar kurrë serbëve. Edhe pse kam qenë në lëvizje, gjithmonë i kam shikuar me dyshim.

Vetë fakti që nuk donin të bashkoheshin në të njëjtën parti, dëshmon diçka?

– Serbët nuk kanë bërë kurrfarë aksioni asnjëherë. Shqiptarët kanë bërë aksione. Kemi shkruar parulla, kemi shpërndarë afishe, trakte. Personalisht më kanë autorizuar t'i shpërndajë do afishe. Erdhi një ditë të shfaqej një film. Ka qenë kinema lëvizëse. E mora obligim t'i çoja ato letra te italianët në kinema. I çova. Edhe disa afishe i çova në prefekturë. Kur më takoi Rifat Berisha, më tha: kush i vuri ato? I thashë, unë. Rexhepi ka mbajtur lidhje me serbë. Unë kam punuar haptas nëpër Gjilan. Kam folur e kam bërë propagandë. Kur e ndërruan Rifat Berishën, e prunë nënprefekt Miftar Spahiu. Menjëherë më kanë burgosur. Ai ka qenë profesor i historisë dhe më ka mësuar mua. Kur erdhi nënprefekt, të parin më burgosi mua.

Sa ditë qëndruat në burg?

– Tre muaj. Si element turbullues.

Kush ju liroi?

– Baca Ramiz. Nuk di a ka dhënë rryshfet a jo. Kur e kam pyetur, më ka thënë se vetëm një pushkë ia ka dhënë dikujt, si nderim për lirim tim.

Ku ishte në detyrë baca Ramiz?

– Në Partesh. Aty gjithmonë ka qenë, dhe nuk e ka lëshuar detyrën deri në fund.

Si kanë qenë marrëdhëniet e Ramizit me Hysenin (Tërpezën)?

– Të mira kanë qenë. Sa kam kuptuar. Hyseni e ka ftuar të iknin për Greqi, por Ramizi nuk ka pranuar. Ka thënë çdoherë, se do të vdes këtu.

Ymer Mollën dhe një partizan çek i kanë pushkatuar në Gjilan. Ai Ymer Mala ishte, por e kishin shënuar ashtu gabimisht "Molla", serbisht i kanë përzier germat. Të tjerët, kur i kanë zënë, shumë kanë qenë serbë, asnjë nuk e kanë vrrarë. Ata dy i ka pushkatua Shefki Gosalci. Thoshin se këta të dy kanë bashkëpunuar me shkie.

A vazhduat punën akoma, a jo?

– Po, more.

Ai kryetari, a jua lëshoi "zagarët" për t'ju ndjekur?

– Paj, sigurisht më kanë ndjekur, por nuk ua kam vënë mendjen.

A e zgjeroi aktivitetin celula juaj komuniste?

– Po, po! Sidomos te të rinjtë.

A kryenit ndonjë aksion?

– Po. Kryesisht veprim në planin propagandistik. Ka qenë aktiv njëfarë Hasan Dylxheri nga Elbasani, që pati ardhur këtu për të punuar. Mbas çlirimit, mua më bënë sekretar të bashkisë së Gjilanit.

Kur kanë hyrë partizanët, keni mbajtur një fjalim aty? Mos nuk u pëlqeu diçka atyre që ishin aty? Sa vjeç ishit atëherë?

– Isha 23 vjeç. U desh të flisja edhe unë. T'i thosha popullit të mos frikoheshin. Patën filluar menjëherë pushkatimet. I merrnin njerëzit natën.

Ploja e njohur e shqiptarëve në Gjilan?

– Atë ditë që e kanë sulmuar Gjilanin, unë ika nga qyteti, shkova në Cernicë. Derisa kaloi ajo furtunë.

Sa janë vrrarë, që ju e keni ditur, afërsisht?

– Pasi hynë shqiptarët, pastaj brigadat partizane, rrugëve kam parë duke bartur kufoma me qerre. Unë shpëtova, s'di pse!

Kur ju emëruan sekretar të bashkisë, a ishit i vetëdijshëm se çka po pranoni?

– Po, fort isha i vetëdijshëm dhe mendoja të ndihmoja për të shpëtuar njerëzit. I kërkoni të gjithë ata që kishin qenë në detyra gjatë pushtimit fashist, me akuza se janë fashistë.

(Intervistë e realizuar nga Sami Dërmaku, botuar në librin "Dëshmi kohe" nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Vizion /Epoka e re/

5 miliardë euro mallra importoi Kosova gjatë 2022-s, 370 milionë janë nga Serbia

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 JANAR - Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka paraqitur të premtën të arriturat e Doganës gjatë vitit të kaluar. Ai ka thënë se nuk është e lehtë të krahasohet viti 2021 me vitin 2022 pasi, sipas tij, viti 2021 ka qenë një vit që ka pasur një performancë të mirë në aspektin ekonomik. “Nuk është e lehtë të krahasohet viti 2021 me vitin 2022, pasi viti 2021 ka pasur një performancë të jashtëzakonshme në aspektin ekonomik”, ka thënë Llugaliu.

Ai ka theksuar se në vitin 2022 vlera e importit ka arritur vlerën e mbi 5 miliardë eurove dhe eksportit mbi 869 milionë euro. “Gjatë këtij viti kemi pasur 11 mijë e 157

aktivitete. Te sekuestrimi i mallrave kemi 11.3 milionë euro, vendimet për inkasim 4.5 milionë euro. Zbulimi i mallrave të ndaluara gjatë vitit 2022 nga zyrtarët doganorë janë 83.6 kilogramë heroinë. Gjatë vitit 2022 kemi pasur lehtësia tregtare, me fillimin e zhdoganimit të plotë në Portin e Durrësit dhe Porto Romano”, ka thënë ai. Llugaliu ka thënë se gjatë vitit të kaluar Dogana e Kosovës ka pasur rritje të të hyrave dhe se Turqia është vendi që Kosova ka import më të madh, ndonëse shtoi se importi nga Serbia ka arritur vlerën e 370 milionë eurove. “Performanca e të hyrave varet nga shumë faktorë, natyrisht që është edhe inflacioni. Turqia është dukshëm vendi që importojmë më shumë. Sa i përket importit nga Serbia kemi pasur 370 milionë euro”,



ka thënë ndër të tjera ai. Llugaliu ka folur edhe për eksportin, teksa tregoi se kishte arritur vlerën në 869.5

milionë euro. “Gjatë vitit 2022 importi ka arritur vlerën 5.603 miliardë euro, ndërsa eksporti 869.5 milionë euro”,

ka thënë ai, duke shtuar se Kosova ka importuar mallra rreth një miliard më shumë krahasuar me vitin 2021.

Kurti e quan qeverinë e tij të mirëqenies për qytetarët



PRISHTINË, 6 JANAR - Kryeministri Albin Kurti, në një shkrim të publikuar në “Facebook”, ka njoftuar se qeveria nën drejtimin e tij ka dhënë mbështetje të vazhdueshme për qytetarët gjatë vitit që lamë pas. “Ndamë shtesa për 30 mijë lehona dhe për 260 mijë fëmijë. Brenda një viti me dy pako mbështetëm drejtpërdrejt rreth 800 mijë qytetarë të Republikës, pothuajse secilën familje. 1) Pako për Ringjallje Ekonomike 100 milionë euro. Dyfishuam asistencën sociale për rreth 26 mijë familje në muajin prill. Ndamë nga 100 euro për rreth: 300 mijë pensionmarrës; 240 mijë punëtorë të sektorit privat; 74 mijë punëtorë të sektorit publik; 50 mijë studentë”, ka bërë me dije Kurti.

Ai ka thënë se shpërndamë afër 37 mijë pako ushqimore për familjet në nevojë. “2) Pako për përballje me inflacion 150 milionë euro. Dyfishuam asistencën sociale për mbi 24 mijë familje në muajin shtator. Ndamë nga 100 euro shtesë për

rreth: 290 mijë pensionmarrës; 12 mijë punëtorë të ndërmarrjeve publike; 51 mijë studentë. Për 76 mijë punëtorët e sektorit publik ndamë nga 50 euro shtesë (shtator - dhjetor). Subvencionuam 50 % të rritjes së pagës për punëtorët e sektorit privat për 3 muajt”, ka thënë ai.

Kryeministri ka theksuar se me skemën e punësimit “Qeveria për Familjet” u punësuan 770 punëtorë. “Me masën 1.3 u punësuan afër 5 000 gra e vajza. Është rihapur thirrja për biznese për mbështetje të 50 % të pagës për 3 muajt e parë nëse punësojnë gra. Në vitin për personat me aftësi të kufizuara u punësuan 239 persona (119 burra dhe 120 gra)”, është shprehur Kurti.

Ai ka thënë se subvencionuan tarifën e energjisë elektrike për të gjithë qytetarët e bizneset që nga shkurti 2022; Faturat e energjisë elektrike për kursimtarët (mbi 200 mijë përfitues); dhe blerjen e pajisjeve eficiente për ngrohje për mbi 8 mijë familje.

Guvernatori i BQK-së: Deficiti tregtar po e pengon rritjen ekonomike

PRISHTINË, 6 JANAR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, thotë se deficiti tregtar është duke ndikuar negativisht në aktivitetin ekonomik të Kosovës ashtu dhe inflacioni i lartë. Përderisa norma e inflacionit, sipas tij, pritët të bjerë në

pjesën e dytë të vitit 2023, Mehmeti thotë se duhet të punohet më shumë që struktura e ekonomisë të ndërrohet në favor të ndërmarrjeve prodhuese. Kosova varet skajshmërisht nga produktet e importuara, ndërsa vlera e eksporteve të saj është shumëfish më e vogël.

Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, Mehmeti flet edhe për valutën kombëtare dhe thotë se BQK-ja i ka ndërmarrë të gjitha masat për zbutjen e efekteve negative të mospasjes së saj. Për krijimin e rezervave të arit ai thotë se duhet të ketë vendim nga autoritetet qeveritare.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ahmet Kandemir rikthehet në "KB Prishtina"

PRISHTINË, 6 JANAR - Trajneri i njohur turk Ahmet Kandemir është rikthyer në Klubin e Basketbollit (KB) "Prishtina" me

ambicie të reja dhe energji të freskëta. Lajmin për rikthimin e tij në kryeqytet e ka dhënë "KB Prishtina". "Nën drejtimin e tij

kemi fituar njërin nga trofetë më të rëndësishëm në historinë e klubit, Kupën e Kosovës në Prizren në vitin 2013. Kandemir

ka drejtuar klubet e njohura turke: Beşiktaş JK, Pınar Karşıyaka, Mersin BB, Antalya BB", ka njoftuar "KB Prishtina".



Ndryshime në stafin e kombëtares shqiptare, zbulohet "urdhri" i Sylvinhos

TIRANË, 6 JANAR - Sylvio Mendes Campos Junior do të paraqitet të hënën si trajner i ri i Shqipërisë. Federata Shqiptare e Futbollit (FShF) ka njoftuar në ditët e para të janarit se është arritur marrëveshja me brazilianin, i cili pason Edoardo Rejan në bankinë e kuqezinjve. 48-vjeçari do të nënshkruajë një kontratë 18-mujore me FShF-në. Objektivi i tij i vetëm është që ta arrijë kualifikimin në fazën finale të Evropianit Gjermani 2024. "Supersport" ka mësuar se Sylvinho ka vendosur të qëndrojë në Tiranë për sa kohë të jetë trajner i kombëtares për të qenë sa më pranë futbollit shqiptar e Federatës Shqiptare të Futbollit. Ai do të jetë i angazhuar maksimalisht gjatë gjithë kohës. Ish-mbrojtësi i majtë ka kërkuar që krahas tij edhe pjesa tjetër e stafit të tij të qëndrojë në Tiranë për të pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm. Në të tilla rrethana, Hamdi Salih, i cili ka qenë pjesë e stafit të kombëtares në rolin e një prej zëvendëstrajnerëve, nuk do të jetë

më pjesë e ekipit kuqez, për faktin se ish-sulmuesi shkodran jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e ka të pamundur të zhvendoset të jetojë në kryeqytet. Ish-mbrojtësi argjentinas Pablo Javier Zabaleta dhe ish-mesfushori brazilian Dorival Guidoni Junior, i njohur si Doriva, janë konfirmuar si ndihmëstrajnerët e Sylvinhos, por "Supersport" ka mësuar se në stafin e brazilianit do të shtohet dhe një përgatitës atletik, i kërkuar nga ana e tij. Ndeshja e parë zyrtare e Shqipërisë në kualifikueset e kampionatit evropian do të jetë në muajin mars në Varshavë ndaj Polonisë, por 48-vjeçari do të ketë edhe një ndeshje miqësore para takimit me polakët për ta njohur skuadrën. Sylvinho është një emër i njohur në futbollin botëror, teksa si lojtar ka qenë pjesë e Barcelonës, Manchester Cityt dhe Arsenalit. Si trajner, më 2011 ai ka marrë pozicionin e zëvendësimit te Cruzeiro, për të kaluar më pas te



Sport Recife, Nautico, Corinthians dhe tek Interi së bashku me Roberto Mancinin. Ai ka qenë edhe zëvendëstrajner i Brazilit për tri vjet, duke mbajtur postin e asistentit të Tite, përpara se ta merrte drejtimin e Lyonit në

Francë dhe më pas Corinthiansit në kampionatin brazilian. Tani ish-anësori kërkon ta bëjë hapin e madh si trajner i Shqipërisë teksa arritja e objektivit do t'i përcaktojë dhe shifrat financiare që do të përfitojë braziliani dhe ndihmësit

e tij për aventurën 18-mujore. Prezantimi i Sylvinhos dhe pjesës tjetër të stafit do të bëhet nga presidenti Armand Duka të hënën në orën 11:00 në ambientet e stadiumit "Air Albania".

Futbolli italian në zi, ndërron jetë Gianluca Vialli



ROMË, 6 JANAR - Ish-sulmuesi i Italisë dhe Chelsea, Gianluca Vialli, ka vdekur në moshën 58-vjeçare pas betejës me kancerin në pankreas. Gianluca Vialli la rolin e tij si trajner me Italinë në dhjetor, duke përmendur nevojën e tij për t'iu nënshtruar trajtimit për kancerin pankreatik. Ish-sulmuesi i Italisë dhe Chelsea u diagnostikua me sëmundjen për herë të dytë në vitin 2021 pasi u trajtua për herë të parë për sëmundjen në vitin 2017. Vialli është diagnostikuar

fillimisht me kancer pankreatik në vitin 2017 dhe më pas për herë të dytë në vitin 2021, menjëherë pas triumfit të Italisë në Euro 2020. Ai ka lënë rolin e tij me Italinë në dhjetor, duke përmendur nevojën e tij për t'iu nënshtruar trajtimit për sëmundjen. Vialli ka luajtur për Cremonese, Sampdoria dhe Juventus përpara se të bashkohej me Chelsea më 1996. Më 1998 ai ishte bërë lojtar-menaxher i "Blueve" pas largimit të Ruud Gullit dhe atë vit e çoi

klubin drejt lavdisë në Kupën e Ligës, Kupën e Fitiesve të Kupës UEFA dhe Superkupën UEFA. Vialli e ka përfunduar karrierën e tij si lojtar në fund të sezonit 1998/99 për t'u fokusuar në menaxhim dhe Chelsea do të fitonte Kupën FA dhe Charity Shield në 2000 nën drejtimin e italianit përpara se ai të shkarkohej në fillim të sezonit 2000/01. Ai ka luajtur 59 ndeshje për Italinë, duke shënuar 16 gola dhe, së fundmi, ka qenë kreu i delegacionit të kombëtares.

Henry dëshiron të bëhet trajner i Belgjikës

BRUKSEL, 6 JANAR - Thierry Henry është duke kërkuar ta marrë drejtimin e kombëtares së Belgjikës. Gazeta belge "HLN" ka raportuar se Henry tashmë ka njoftuar sindikatat se është i

hapur për këtë pozicion. Që nga viti 2021 francezi ishte i dyti në bankinë së bashku me Roberto Martinezin. Largimi i spanjollit e ka lënë Henryn të pozicionuar shumë mirë.

Një nga lojtarët e asaj skuadre, Lukaku, tashmë e ka bërë të qartë se do të dëshironte që Henry të ishte trajneri i radhës: "Për mua ai është trajneri ideal i skuadrës". Data maksimale për paraqitjen e

kandidaturës do të jetë e marta e ardhshme, 10 janari dhe, pasi të mbyllet, federata belge do të duhet të vendosë mes aplikantëve se kush do të jetë personi ideal për ta drejtuar Belgjikën.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for Human Resources

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 04/01/2023 me nr ref: DBN 07/01/2023, Policia e Kosovës për të gjitha minoritetet shpall:

KONKURS

Për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas).

Vendi i punës: Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri.

A. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet t'i përmbushin këto kritere:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh (fyturë, qafë, duar);
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

B. Testet:

- Testi me shkrim;
- Testi i aftësive fizike;
- Intervista;
- Testi psikologjik;
- Kontrollimi mjekësor;
- Verifikimi i të kaluarës.

C. Forma e aplikimit:

Aplikimi të bëhet në formën fizike që nënkupton se aplikacioni duhet të shkarkohet nga faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në adresën www.kosovopolic.com / **Shpallje/Mundësi punësimi** Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentet tjera mund dërgohet fizikisht në stacionin më të afërt të Policisë ose të dërgohet përmes postës elektronike (email) në adresën: rekrutimi@KosovoPolice.com.

D. Në aplikim duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera;
- Certifikatën e lindjes/ekstrakt i lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetim;
- Kopje e letërnjoftimit apo pasaportës
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokument nga pika **c** dhe **d** të jenë të vlefshme dhe të nxirën pas datës së shpalljes së konkursit.

E. Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë

- Të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat;
- Të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- Të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
- Të parandalojnë dhe t'i zbulojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të hetojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë sigurinë në komunikacion;
- Të menaxhojnë dhe të kontrollojnë kufirin shtetëror;
- Të ofrojnë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- Të kryejnë detyra të tjera të parapara me Ligjin e Policisë.

Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë nga data **05/01/2023 deri me datën 26/01/2023**.

Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 038-5080 lokali: 1554 apo 1722 si dhe në 038/245-184, prej orës 09:00-15:00.

Pas përzgjedhjes së aplikacioneve kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimet e cekura më lart.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testimet do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolic.com dhe në tabelat e shpalljeve nëpër Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore përkatëse.

“Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga këto minoritete”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for Human Resources

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o Radu Br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativnog Uputstva 01/2021 o radnom odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9 tačka 1 i 2, i Odluku Generalnog Direktora datuma: 04/01/2023 pod ref br: DLJI 07/01/2023, Policijska Kosova za sve manjine objavi:

KONKURS

Za prijem policijskih službenika po pretpostavkama konkursa za sve manjine (Serbi, Bošnjaci, Turci, Gorani Romi, Aškali, Egipcani, Hrvati, Crnogorci, Makedonci),

Radno mesto: Regionalna Direkcija Policijska Kosova Mitrovica Sever

A. Kandidati koji se prijavljuju za policijske službenike u Policiji Kosova moraju ispuniti sledeće kriterijume:

- Da bude Državljanin Republike Kosova ;
- Imati 18-30 godina ;
- Da ima završeno srednje obrazovanje ;
- Da je u dobrom fizičkom, psihičkom, i emocionalnom stanju;
- Da nije osudjivan za krivično delo ;
- Da nema tetovažu na vidljivom mestu (lice, vrat, ruke) ;
- Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti .

B. Testovi :

- Pismeni test ;
- Test fizičkih sposobnosti ;
- Intervju ;
- Psihološki test ;
- Lekarski pregled ;
- Provera prošlosti .

C. Formular prijave :

Prijave na konkurs za policijske službenike , biće na fizičkom obliku ,što podrazumeva da se aplikacija treba da se preuzima sa službene stranice PK : www.kosovopolic.com / **Oglas/Mogućnosti zapošljavanja, za popunjavanje**. Popunjena aplikacija zajedno sa ostalom dokumentacijom može da se dostavi u fizičkom obliku u najbližoj stanici policije ili da se dostave skenirano preko email adrese: rekrutimi@Kosovopolic.com

D. Na aplikaciji , moraju biti priloženi zahtevani dokumenti uz prijavu kao što su :

- Kopija diplome o visokom , srednjem obrazovanju , dok za kandidate koji su obrazovanje završili u inostranstvo, overenu kopiju diplome ;
- Dokaz o drugim kvalifikacijama ;
- Izvod iz matične knjige rođenih /izvod rođenih ;
- Uverenje od suda da nije osudjivan i da nije pod istragom ;
- Kopija lične karte , ili pasoša
- Fotografija formata (5 x 5);
- Dokument iz tačaka **c** i **d** moraju biti validni i zacrnjeni nakon datuma objavljivanja konkursa .

E. Dužnosti i opšte dužnosti Policijske

- Da zaštiti život, imovinu i obezbediti sigurnost svih lica ;
- Da štiti osnovna prava i slobode svih lica ;
- Sprečavanje opasnost po građane i održavanje reda i javne bezbednosti;
- Sprečavanje i otkrivanje krivičnih dela i njihovih izvršilaca ;
- Da istražuje krivična dela i njihove izvršioce ;
- Nadgleda i kontroliše bezbednost saobraćaja ;
- Upravlja i kontrolisati državnu granicu ;
- Pružanje pomoći tokom prirodnih katastrofa i drugih vanrednih slučajeva; i
- Obavlja druge poslove predviđene sa Zakonom o Policiji .

Zainteresovani kandidati mogu da apliciraju od datuma **05/01/2023 do datuma 26/01/2023**.

Za detaljne informacije možete se obratiti na brojeve telefona t: 038-5080 lokalini : 1554 ili 1722 kao i na 038/245-184, od 09:00 do 15:00 časova .

Nakon selekcije prijave , uspešni kandidati će biti pozvani da učestvuju na gore navedenim testovima. Informisanje kandidata u vezi sa svakom etapom testova biće objavljene na zvaničnom sajtu Policijske Kosova , i na adresi: www.kosovopolic.com kao i na oglasnim tablama u relevantnim Regionalnim Direkcijama i Policijskim Stanicama .

“Policijska Kosova služi svim građanima Kosova. Ova služba nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova , i pozdravlja prijave svih muških i ženskih lica iz ovih manjina ”.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr.464/01-57437/2
Datë: 05.01.2023

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM PRELIMINAR

I. PLOTËSOHET dhe NDRYSHOHET, Vendimi Preliminar INr.464/01-57437 i datës 07.12.2022, të Përshkrimit detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale për shpronësim për rrugën "Bashkim Krasniqi" në Lipjan, dhe ri formulohet tabela me shenimet si vijon:

K.K. Lipjan					K.K. Lipjan				
Gjendja e vjetër					Gjendja e re				
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe e mbetur m ²	Sipërfaqe për rrugë m ²
1.	Nebojsa Andrijevic (Dragisha)	P-71409044-01857-1 ZK Lipjan	Arë e kl.1	442	Gjerëtanishmi	E re		282	160.00
2.	Lubisha Andrejeviq (S.)	P-71409044-01857-2 ZK Lipjan	Arë e kl.1	1684	Gjerëtanishmi	E re		1502	182.00
3.	Novica Jorgiq (Stojadin) Milena Laziq (Stojadin) Zorica Daniqiq (Stojadin)	P-71409044-01879-1 ZK Lipjan	Arë e kl.1	1137	Gjerëtanishmi	E re		936	201.00

17.	Basri Grajqevci (Hamit)	P-71409044-01944-8 ZK Lipjan	Livadh i Kl.1	250	Gjerëtanishmi	E Re		195	55.00
18.	Gafurr Buja	P-71409044-01943-2 ZK Lipjan	Arë e Kl.1	943	Gjerëtanishmi	E Re		609	334.00
19.	Gafurr Buja	P-71409044-01944-9 ZK Lipjan	Livadh i Kl.1	21	Gjerëtanishmi	E Re		0	21.00

II. Vendimi Preliminar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetat ditore.

I'u dërgohet:
-të gjitha Drejtorive
-Arkivit të Komunës



4.	Novica Jorgiq (Stojadin) Milena Laziq (Stojadin) Zorica Daniqiq (Stojadin)	P-71409044-01878-4 ZK Lipjan	Arë e kl.1	675	Gjerëtanishmi	E re		553	122.00
5.	Miladin Jorgiq (Agapija)	P-71409044-01878-1 ZK Lipjan	Arë e kl.1	746	Gjerëtanishmi	E re		629	117.00
6.	Miladin Jorgiq (Agapija)	P-71409044-01880-0 ZK Lipjan	Arë e kl.1	5271	Gjerëtanishmi	E re		5176	95.00
7.	Zhivajna Jorgiq (Agapija)	P-71409044-01881-1 ZK Lipjan	Arë e kl.1	4420	Gjerëtanishmi	E re		4009	411.00
8.	Blorim Fazliu (Xhezahir)	P-71409044-01167-6 ZK Lipjan	Arë e kl.1	1690	Gjerëtanishmi	E re		1532	158.00
9.	Ninoslav Dejanoviq Nadica Megee (Novica)	P-71409044-01167-7 ZK Lipjan	Arë e kl.1	374	Gjerëtanishmi	E re		0	374.00
10.	Ninoslav Dejanoviq Nadica Megee (Novica)	P-71409044-01167-8 ZK Lipjan	Arë e kl.1	97	Gjerëtanishmi	E re		0	97
11.	Milosh Laliq (S.)	P-71409044-01940-2 ZK Lipjan	Kullosë e kl.1	676	Gjerëtanishmi	E re		638	38.00
12.	Miodrag Radiq (Petra)	P-71409044-01941-4 ZK Lipjan	Kallamishte e Kl.1	180	Gjerëtanishmi	E re		157	23.00
13.	Miodrag Radiq (Petra)	P-71409044-01941-5 ZK Lipjan	Kallamishte e Kl.1	200	Gjerëtanishmi	E re		87	113.00
14.	Miodrag Radiq Zhivorad (Petra) Radiq	P-71409044-01941-2 ZK Lipjan	Kallamishte e Kl.1	1346	Gjerëtanishmi	E re		1096	250.00
15.	Jelica Arsiq (UD.Ljubomira)	P-71409044-01942-1 ZK Lipjan	Kullosë e Kl.1	1230	Gjerëtanishmi	E re		813	417.00
16.	Rexhep Tahiri (Sadik)	P-71409044-01944-7 ZK Lipjan	Livadh i Kl.1	376	Gjerëtanishmi	E Re		330	46.00



THIRRJE PER OFERTIMIN E PAISJEVE DHE MJETEVE NE KUADER TE PROJEKTIT "SUPPORT THE EMPLOYMENT OF YOUTH IN ENERGY SECTOR"

Hapet thirrja per ofertimin e paisjeve dhe mjeteve te specifikuar sipas termave te references. Oferta duhet te dergohet ne formen e Annex 1 te bashkangjitur me poshte, ne forme elektronike ne info@bsckosovo.org me se largu me 8 Janar 2022.

Linku I shpalljes:
<https://bsckosovo.org/2022/12/13/thirrje-per-ofertimin-e-paisjeve-dhe-mjeteve-ne-kuader-te-projektit-support-the-employment-of-youth-in-energy-sector/>



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PRESDNIK OPŠTINE

1Br.464/01-57437/2
Dana:05.01.2023

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4 i člana 10 zakona Br.03/L-139 Eksproprijaciju nepokretne Imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 promene i dopune obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Nr.20/21 Juni 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt 24.12.2021, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

PRELIMINARNA ODLUKA

I. DOPUNUJE SE I PROMENUJE SE, Preliminarna Odluka 1Br.464/01-57437 dt. 07.12.2022, na detaljan opis katastarskih parcela prema Sertifikat-katastarskoj jedinici za eksproprijaciju za ulicu „Bashkim Krasniqi“ u Lipljanu, i tabela je preformulisana sa sledećim napomenama:

K.K. Lipjan Staro Stanje					K.K. Lipjan Novo Stanje				
Br.	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Kultura-klasa	Površina m ²	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Kultura-klasa	Ostatak površine m ²	Površina za put m ²
1.	Nebojsa Andrijević (Dragiša)	P-71409044-01857-1 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	442	Dosadašnji	Novo		282	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		160.00
2.	Lubisha Andrejević (S.)	P-71409044-01857-2 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	1684	Dosadašnji	Novo		1502	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		182.00
3.	Novica Jorgiq (Stojadin)	P-71409044-01879-1 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	1137	Dosadašnji	Novo		936	
	Milena Laziq (Stojadin)				Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		201.00
	Zorica Daniqiq (Stojadin)								

4.	Novica Jorgiq (Stojadin)	P-71409044-01878-4 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	675	Dosadašnji	Novo		553	
	Milena Laziq (Stojadin)				Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		122.00
5.	Miladin Jorgiq (Agapija)	P-71409044-01878-1 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	746	Dosadašnji	Novo		629	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		117.00
6.	Miladin Jorgiq (Agapija)	P-71409044-01880-0 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	5271	Dosadašnji	Novo		5176	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		95.00
7.	Zhivojina Jorgiq (Agapija)	P-71409044-01881-1 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	4420	Dosadašnji	Novo		4009	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		411.00
8.	Blorim Fazliu (Xhezahir)	P-71409044-01167-6 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	1690	Dosadašnji	Novo		1532	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		158.00
9.	Ninoslav Dejanović	P-71409044-01167-7 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	374	Dosadašnji	Novo		0	
	Nadica Megec (Novica)				Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		374.00
10.	Ninoslav Dejanović	P-71409044-01167-8 ZK Lipjan	Njiva e kl.1	97	Dosadašnji	Novo		0	
	Nadica Megec (Novica)				Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		97.00
11.	Milosh Laliq (S.)	P-71409044-01940-2 ZK Lipjan	Pasnjak e kl.1	676	Dosadašnji	Novo		638	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		38.00
12.	Miodrag Radiq (Petra)	P-71409044-01941-4 ZK Lipjan	Trstik e Kl.1	180	Dosadašnji	Novo		157	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		23.00
13.	Miodrag Radiq (Petra)	P-71409044-01941-5 ZK Lipjan	Trstik e Kl.1	200	Dosadašnji	Novo		87	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		113.00
14.	Miodrag Radiq (Petra)	P-71409044-01941-2 ZK Lipjan	Trstik e Kl.1	1346	Dosadašnji	Novo		1096	
	Zhivorad Radiq (Petra)				Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		250.00
15.	Jelica Arsiq (UD.Ljubomira)	P-71409044-01942-1 ZK Lipjan	Pasnjak e Kl.1	1230	Dosadašnji	Novo		813	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		417.00
16.	Rexhep Tahirl (Sadik)	P-71409044-01944-7 ZK Lipjan	Livada Kl.1	376	Dosadašnji	Novo		330	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		46.00

17.	Basri Grajqevci (Hamit)	P-71409044-01944-8 ZK Lipjan	Livada i Kl.1	250	Dosadašnji	Novo		195	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		55.00
18.	Gafurr Buja	P-71409044-01943-2 ZK Lipjan	Njiva e Kl.1	943	Dosadašnji	Novo		609	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		334.00
19.	Gafurr Buja	P-71409044-01944-9 ZK Lipjan	Livada i Kl.1	21	Dosadašnji	Novo		0	
					Opština Lipljan	S.O. Lipljan	Lokalni Put		21.00

II. Odluka stupa na snagu nakon objavljivanja na Službenom Novinu Republike Kosova i nakon objavljivanja u jednom od novina sa najvećim tiražom.

Dostavljen:
-svim Direkcijama
-Arhive Opštine



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bashkim Rexhep Jashari shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik Prishtinë, me nr. 5052.

- Orhan Avdiu shpalle te pavlefshme diplomën dhe deftesat e SHMLM " DR XHELADIN DEDA"

- Anita Miftari shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLM : Dr xheladin Deda"

- Dion Gashi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLE " Hasan Prishtina"

- Avni Emini B.I shpalle te pavlefshme certifikaten e biznesit me nrb: 600326351

- Artur Susuri shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Herolind Hoxhaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren .

- Bledion Elshani shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane .

- Fatmir Telaku shpall te pavlefshme deftesat e kl X, XI shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Petrit Hajdari shpall të pavlefshme deftesat e shkollës fillore nga kl. 6-9 të shkollës "Rasim Kijana" Drenas.

- Mirjeta Sadrija nga Damjani shpall të pavlefshme deftesën e plotë të SH.F. "Pjeter Bogdani" nga kl. I-VIII.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

